

URDHËR
Nr. 269, datë 26.5.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”; të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 21, datë 1.3.2023, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z. Ergys Qirici, te drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Lefkothea Lite, për periudhën 20 qershor 2023–27 qershor 2023.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen përgjatë periudhës së pamundësisë së ardhjes në punë të drejtorit të Përgjithshëm si rezultat i kryerjes së lejes vjetore.
 3. Në kompetencat e deleguara nuk përfshihen kompetencat e nëpunësit autorizues të institucionit për veprimet pranë Degës së Thesarit Tiranë.
 4. Ngarkohet znj. Lefkothea Lite për zbatimin e këtij urdhri, sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.
- Ky urdhër hyn në fuqi më datë 20.6.2023 dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ergys Qirici